



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më datë 01.03.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i kalendarit trejavor të punimeve të Komisionit.
2. Miratimi i procesverbalit të datës 12 shkurt 2019.
3. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”
4. Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ditmir Bushati, Bashkim Fino dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Nard Ndoka, Rudina Hajdari, Evis Kushi, Alket Hyseni dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Besfort Lamallari – Zëvendësministër i Brendshëm

Dalimir Kurti – Specialist në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive në Ministrinë e Brendshme

Aurora Alimadhi – Zëvendësdrejtoreshë Ekzekutive dhe Drejtoreshë e Departamentit të Zhvillimit Rajonal në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Greta Gjoncaj – Përgjegjëse e Njesisë së Kërkim-Zhvillimit në Departamentin e Zhvillimit Rajonal në Fondin Shqiptar të Zhvillimit

Thimio Plaku – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ela Dobi – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Nikolin Bërzhiku – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

HAPET MBLEDHJA

Mimi Kodheli – Përshëndetje të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e sotme të Komisionit për Politikën e Jashtme, datë 1 mars 2019, me këtë rend dite: miratimin e kalendarit trejavor të punimeve të Komisionit, miratimin e procesverbalit të datës 12 shkurt 2019, për të vijuar me ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017” dhe shqyrtimin e projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Keni ndonjë vërejtje, zotërinj deputetë, lidhur me kalendarin trejavor të punimeve të komisionit? Nëse nuk ka ndonjë gjë, e konsiderojmë të miratuar.

Ka vërejtje për procesverbalin e mbledhjes së datës 12.02.2019?

(Të pranishmit shprehen dakord.)

Miratohet.

Vijojmë me shqyrtimin e projektligjit të parë “Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes për bashkëpunimin teknik ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban, dhe qeverisë së Konfederatës Zvicerane, të përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim, për programin e zhvillimit rajonal për Shqipërinë, ratifikuar me ligjin nr. 66/2017”.

Të pranishme nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit kemi zonjat Greta Gjonçaj, përgjegjëse e Njesisë së Kërkim-Zhvillimit në Departamentin e Zhvillimit, dhe zonjën Aurora Alimadhi, e cila është zëvendësdrojtoreshë Ekzekutive dhe Drejtoreshë e Departamentit të Zhvillimit Rajonal në Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Jam saktë, zonjë, jeni njëkohësisht zëvendësdrojtoreshë ekzekutive dhe drejtoreshë e një departamenti?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ndërsa nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë kemi zotin Plaku, drejtor i Përgjithshëm, si dhe zonjën Dobi dhe zotin Bërxhiku, specialistë.

Mirë se keni ardhur!

Fillojmë me ratifikimin e marrëveshjes së parë.

Fjalën e ka zonja Alimadhi.

(Zonja Alimadhi flet pa mikrofon.)

Aurora Alimadhi – ...vjen si nevojë e vendosjes së disa ndryshimeve në tekstin e marrëveshjes për sa u përket palëve bashkëpunuese në marrëveshje dhe njëkohësisht për shtyrjen e afatit të zbatimit të marrëveshjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Faleminderit!

Programi për zhvillimin rajonal është iniciuar në datën 01.04.2017, në zbatim të marrëveshjes së bashkëpunimit, të miratuar me vendimin e datës 29.03.2017...

Mimi Kodheli – Zonja Alimadhi, ju kërkoj ndjesë!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Deputetët e kanë përpara raportin lidhur me këtë ratifikim.

Ju lutem, dy fjalë shteruese se ku konsiston marrëveshja dhe pse kërkon ta shtyni afatin.

Aurora Alimadhi – Faleminderit!

Atëherë, në thelb, ky ndryshim konsiston në përfshirjen e zëvendëskryeministrit dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit, si palë bashkëpunuese me Konfederatën Zvicerane, përfaqësuar nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim.

Sikurse jeni në dijeni, si fillim, marrëveshja është nënshkruar nga qeveria e Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Zhvillimit Urban. Për shkak të ndryshimeve që ndodhën në përbërjen e qeverisë, tashmë ka nevojë që kompetencat, të cilat i atribuoheshin Ministrisë së Zhvillimit Urban, t'i atribuohen një strukture tjetër. Konkretisht, në rastin e kësaj marrëveshjeje ndryshuese, në rolin e palës bashkëpunuese është përfshirë edhe zëvendëskryeministri.

Kjo marrëveshje ka tri objektiva kryesorë: krijimin dhe miratimin e kuadrit ligjor për zhvillimin rajonal, që përfshin projektligjin dhe aktet nënligjore, si dhe dy komponentët e tjerë, që kanë të bëjnë me përgatitjen e institucioneve në mënyrë që të bëhen të gatshme për të përthithur fonde të Bashkimit Europian, si dhe komponentin për përmirësimin e jetës nëpërmjet zhvillimit dhe dhënies së granteve njësisive të pushtetit vendor.

Sipas marrëveshjes, zëvendëskryeministri do të jetë përgjegjës për komponentin e parë, kurse Fondi Shqiptar i Zhvillimit do të jetë përgjegjës për ndjekjen dhe bashkëpunimin për dy objektivat e tjera. Afati parashikohet të shtyhet deri në datën 31 mars 2019. Procedurat kanë nisur herët dhe mendojmë se brenda këtij afati do të realizohet përmbyllja me sukses e projektit.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Pra, flasim për shtyrje vetëm me 1 muaj.

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Ka drejtor projekti, apo jo?

Ju çfarë detyre keni atje? Drejtori që ishte në kohën e Damian Gjickurit nuk kishte lidhje me ministrinë. Ka drejtor projekti që të na thotë nëse ky projekt mbaron vërtet në datën 31. 03. 2019.

Kryetare, këta kanë pasur një marrëveshje me zviceranët që në kohën kur ka qenë zonja Gjermani ministre. Pas ardhjes së qeverisë së re, ato kaluan nën kujdestarinë e zotit Gjickuri, Ministrinë e Energjetikës dhe Infrastrukturës. Tani na thonë që nuk do të jetë më ministria e linjës ajo që do ta ndjekë, por do të jetë zëvendëskryeministri, i cili në këto momente është kryetar bordi i Fondit të Zhvillimit Shqiptar. Duhet të mbaronin që në fund të muajit korrik të vitit të kaluar, por duan ta shtyjnë edhe 6 muaj. Te ne e sollën dje, në datën 28 shkurt, kurse te ju e sollën sot, në datën 1 mars, ndërkohë që duhet ta kishin sjellë që në korrik të vitit të kaluar.

Na garanton drejtori i projektit që mbaron brenda këtij muaji? Akti normativ nga qeveria do të dilte që vjet nëse do të kërkohej shtyrja me 6 muaj.

E dyta, zëvendëskryeministri është institucion si kryetar bordi dhe jo ministri linje që ndjek politikën. Nga kjo pikëpamje, me këtë marrëveshje këta nuk mund të thonë që këtë çështje e ka zëvendëskryeministri. Pavarësisht se unë e kam thënë edhe në diskutimin e projektbuxhetit të vitit të kaluar për Fondin e Zhvillimit Shqiptar, që është jashtë sistemit financiar, qoftë për pagat apo të tjera, ajo duhet të jetë brenda sistemit. Tani thonë që duhet të jetë zëvendëskryeministri. Zëvendëskryeministri ka qenë edhe më përpara kryetar i bordit. Pse ia heqin tani ministrisë së linjës këtë marrëveshje? Qeveria zvicerane e ka nënshkruar këtë marrëveshje me ministrinë e linjës. Më parë ka qenë ministre zonja Gjermani dhe më pas ka ardhur zoti Gjickuri. Ky zotëri nuk ka ardhur kot këtu, sepse ky është një nga drejtorët e MIE-së. Ose të vinin nga zyra e zëvendëskryeministrit, ose të vinte drejtori i projektit për këtë çështje. E sqarova këtë ngaqë bëra debat dje dhe, meqë m'u dha mundësia thashë mos marr ndonjë gjë më shumë, por nuk mora gjë më shumë pavarësisht se jemi më 1 mars.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Të shpresojmë nëse do të marrim ndonjë informacion më shumë. Pyetjet janë 3: Pse nuk keni ardhur në korrik? Kush është drejtor i projektit? Pse vendoset zëvendëskryeministri dhe nuk lihet ministria e linjës? Përgjigjuni ju ose dikush tjetër.

Fjala për ju, zonjë!

Aurora Alimadhi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt procedurat janë inicuar që në korrik të vitit 2018. Miratimi në parim i kësaj marrëveshjeje është bërë me vendimin nr. 612, datë 19.10.2018.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, në tetor 2018 është bërë miratimi në parim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka marrë kohën e mjaftueshme të nënshkrimit dhe më pas të konsultimit, të bashkërendimit me ministritë deri sa ka kaluar përsëri në KM për ratifikim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Atëherë, ju thatë që më 9 tetor, kur daton VKM-ja.

Jam e saktë?

Aurora Alimadhi – 19 tetori.

Mimi Kodheli – Po e vë 20 tetor, po ta fal një ditë. Nga kjo datë deri sot ka kaluar në proces konsultimi midis ministrive të linjës dhe palëve të interesuara për të ardhur rishtaz në parlament?

Aurora Alimadhi – Zonja kryetare,

Është bërë miratimi i tekstit të marrëveshjes në parim nga KM-ja.

Mimi Kodheli – Më 20 tetor?

Aurora Alimadhi – Po. Në përputhje me ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare. Më pas, teksti i marrëveshjes së miratuar në parim nënshkruhet...

Mimi Kodheli – Është diskutuar në terma reference.

Aurora Alimadhi – Jo, teksti i marrëveshjes së miratuar në parim nënshkruhet ndërmjet palëve.

Mimi Kodheli – Dakord, është nënshkruar më 20 tetor. Pra, është miratuar vetëm teksti, si një VKM.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Aurora Alimadhi – Miratimi i tekstit të marrëveshjes është bërë në parim më 20 tetor. Ky tekst i miratuar në parim nga KM-ja, duhet të nënshkruhet nga palët dhe ky nënshkrim është bërë vonë.

Mimi Kodheli – Cilat janë palët?

Aurora Alimadhi – Palët janë: KM-ja i përfaqësuar nga zëvendëskryeministri, FSHZH-ja në rolin e agjencisë bashkëpunuese dhe ambasadori i Konfederatës Zvicerane.

Mimi Kodheli – Pra, më 20 tetor është miratuar teksti i marrëveshjes. Pra, qeveria ka qenë dakord me tekstin përderisa e ka miratuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Kur them qeveria, është edhe FSHZH-ja brenda, sepse ju nuk jeni një agjenci që punoni *ex officio*.

Aurora Alimadhi – Po.

Mimi Kodheli – Bukur. Pra, nga 20 tetori dhe deri më sot ka qenë vetëm procedura që ky tekst të firmoset edhe nga ambasadori zviceran, që përfaqëson paratë e qeverisë zvicerane. Jam e saktë?

Aurora Alimadhi – Po, zonjë, jeni e saktë.

Mimi Kodheli – Kaq desha të di. Madje konfederatë. Ndoshta, janë pyetur të gjitha kantonet atje. Mund të jetë bërë referendum në Zvicër për këtë. Më falni për ironinë, por nuk ka lidhje me ju!

Kjo ishte njëra çështje.

Tani vijmë te pyetja e zotit Fino: Cili është drejtori i projektit? Kush e drejton projektin?

Aurora Alimadhi – FSHZH-ja në këtë rast është agjencia bashkëpunuese dhe përfituese e produktit, ndërsa zbatimi i projektit bëhet nga një shoqëri e përzgjedhur nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim, në bazë të një tenderi ndërkombëtar. Kjo shoqëri quhet Ecorys dhe është shoqëri ndërkombëtare. Kjo është shoqëria zbatuese e projektit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Dakord.

Zonja Hysi e ka fjalën. Më pas do të flasë zonja Gjermani.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Në fakt, dje dhe sot, zoti Fino ngriti një shqetësim, por unë e shoh në pikëpamjen e rëndësisë që do të ketë kjo marrëveshje.

Sot po diskutojmë marrëveshjen, që do të kalojë në seancë plenare javën e ardhshme. Marrëveshja do të shkojë për t'u dekretuar nga Presidenti dhe do të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Data 31 mars, që është data e përfundimit të zbatimit të projektit, ka skaduar. Për një moment duhet të mendojmë që mund të lindë një konflikt mes palëve. Ju e vini parlamentin në pozitë të vështirë, sepse marrëveshja hyn në fuqi tej afatit që përmban...

Si është menduar kjo? A jeni realistë me këtë afat, me datën 31 mars të 2019-s?

Mimi Kodheli – Duhet t'ia thuash qeverisë këtë, jo zonzës.

Vasilika Hysi – Qeverisë ia sjellin palët. Nuk besoj se e shkruan qeveria, zonja kryetare.

Këtu është thjesht ndryshim emri dhe përgjegjësi, apo ka edhe punime? Nuk e marr vesh se çfarë do të bëni deri në datën 31 mars. Nga relacioni nuk del kjo.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Zonja Gjermani e ka fjalën. Më pas do të flasë zoti Bushati.

Eglantina Gjermani – Faleminderit, zonja kryetare!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ky komision ka një rregull...

Eglantina Gjermani – Kam qenë ministrja që e ka firmosur këtë marrëveshje në 2017-n dhe e kam njohur pak më shumë. Edhe dje isha relatores te Komisioni i Veprimtarive Prodhuese. Pa dyshim, shqetësimet që ngritën zoti Fino dhe zonja Hysi janë shumë të drejta. Këto shqetësime i ngritëm edhe ne te Komisioni i Veprimtarive Prodhuese.

Në kontekstin e realizimit brenda afatit, brenda 31 marsit, u angazhuan edhe dje në komision dhe mendojnë se brenda 1 marsit do t'i përfundojnë të gjitha aktivitetet.

Deri tani kanë realizuar një sërë objektivash të kësaj marrëveshjeje, por ajo që kërkuam dje, në fakt, ishte një informacion me shkrim lidhur me çfarë është realizuar deri më tani nga ky projekt, sa fonde kanë mbetur deri më 31 mars, dhe a kanë mundësi t'i realizojnë objektivat. Duhej të ishte thënë. Mungon në relacion, dhe janë angazhuar përfaqësuesit e qeverisë që, të paktën te komisioni ku ishim ne, por besoj se kjo është e vlefshme për të gjithë komisionet, brenda ditës së sotme të na i sjellin me shkrim gjithë informacionin: çfarë është realizuar dhe çfarë do të vazhdojë të realizohet brenda 31 marsit.

Besoj se kjo është arsyeja që ka ardhur me procedurë të përshpejtuar, meqenëse bëhet fjalë për 31 marsin. Të njëjtin shqetësim kam: faktin nëse do të arrini t'i realizoni dot të gjitha brenda muajit mars. Besoj se ne, si Komisioni i Jashtëm, kemi merakun dhe përgjegjësinë t'i shikojmë gjërat nga perspektiva që i takon këtij komisioni. Mendoj se shqetësimi kryesor është realizimi i afatit dhe nëse kemi mundësi të ndryshojmë apo jo marrëveshjen. Këshilltarët juridikë na thanë se nuk mund të ndërhyjmë as te ndryshimi i datës: ose e miratojmë, ose e hedhim poshtë.

Kësisoj, në kushtet ku jemi sot, ne kemi mundësinë që t'i miratojmë, siç dhe mendoj se duhet bërë. Padyshim,. Falënderojmë edhe qeverinë zvicerane për ndihmën, bashkëpunimin dhe gjithë kontributin që jep, sidomos në kuadrin e zhvillimit rajonal. Nuk e ndryshojmë dot as afatin. Na thanë se, juridikisht, nuk kemi të drejtë ta shtyjmë afatin edhe një muaj, për shembull. Pra, jemi para këtij fakti.

Faleminderit!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mimi Kodheli – Ministri Bushati.

Ditmir Bushati – Në vazhden e kësaj që tha zonja Gjermani, do të doja të shtoja këto elemente: e para, kjo është një marrëveshje, dhe është në tagrin e Këshillit të Ministrave, që të përcaktojë se kush do ta firmosë në emër të Këshillit të Ministrave. Mund të jetë problem praktik nga pikëpamja e zbatimit të marrëveshjes, por mënyrën se si përfaqësohet Këshilli i Ministrave, në nivel ministri apo zëvendëskryeministri, këtë e përcakton vetëm Këshilli i Ministrave. Nuk mund t'i imponohemi Kuvendit t'i themi qeverisë se do të kemi këtë nivel përfaqësimi. Nuk është e thënë që gjatë rrugës, palët të mos bien dakord, që të ketë një autoritet të ri përfaqësimi apo qeveria të mendojë se zëvendëskryeministri mund të jetë më efektiv për të koordinuar disa institucione, jo vetëm fondin shqiptar, por edhe institucione të tjera, që mund të jenë përfituese indirekte nga zbatimi i kësaj marrëveshjeje.

E dyta, mendoj se në problemin ligjor, duke u nisur edhe nga eksperiencia e marrëveshjeve ndërkombëtare, për një marrëveshje të tillë Presidenti i Republikës lëshon dokumentin paraprak apo dakordësinë e tij, për të vijuar procedurat e autorizimit. Nuk mendoj se do të jemi në kolaps ligjor.

E treta, ky është një projekt që e kam ndjekur nga larg, dhe përgjithësisht ndihma që jep qeveria zvicerane është e mirëseardhur. Është e rëndësishme që ne, si komision, të fokusohemi te çështja politike dhe impakti publik që do të ketë projekti, e të mos ngulmojmë shumë tek afatet. Pse e them këtë? E them edhe nga eksperiencia e marrëveshjeve financiare që kemi pasur me Bashkimin Europian, që janë bërë objekt diskutimi në këtë komision. Jo në çdo rast cikli buxhetor është përputhur, kjo për arsye nga më të ndryshmet, që kanë të bëjnë edhe me programimin e institucioneve mbështetëse e jo vetëm, të qeverisë shqiptare. Pra, nuk ka të bëjë thjesht me kapacitetet tona planifikuese dhe implementuese, por ka të bëjë edhe me palën tjetër. Jo në çdo rast janë puqur këto afate.

Besoje se, si çdo draft-marrëveshje ndërkombëtare, ne nuk kemi as luksin, as mjetin e as instrumentin për ta ndryshuar atë. Ne ose e pranojmë, siç e tha zonja Gjermani, ose e kundërshtojmë.

Nga ana tjetër, në lidhje me rastin në fjalë, është e drejta jonë të kemi më shumë informacion dhe të monitorojmë zbatimin e kësaj marrëveshjeje të mirëpritur.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti Fino!

Bashkim Fino – Kam vetëm një sugjerim, në lidhje me rezymenë që bëri kolegu Bushati, te pjesa e fundit. Nuk ka asgjë të keqe, nëse ne i themi qeverisë që të jetë më efektive në bërjen e marrëveshjeve dhe moszvarritjen e këtyre marrëveshjeve për 6 muaj.

Më lejoni t'ju them se kjo projekt marrëveshje që do të kalojë, mbaronte më 30 korrik, në mos gaboj? Pra, këta kishin kohë përpara se të mbaronte marrëveshja të negociacionin, të diskutonin, nëse donin ta shtynin 6 muaj. Shumë mirë që e shtynë 6 muaj dhe jam plotësisht dakord ta miratojmë shtyrjen 6 muaj. 6 -muajshi mbaron më 31 mars të këtij viti. Negociatat për ta bërë për 6 muaj më duken jo normale. Shikoni me kujdes: më 22 shkurt të këtij viti, para 10 ditëve, ka dalë akti i qeverisë, vendimi i qeverisë. I bie afërsisht 5 muaj e gjysmë negociata që kanë bërë ata me qeverinë zvicerane për ta sjellë, ndërkohë kanë qenë dakord që ky projekt duhej të shtyhej edhe 6 muaj, sepse nuk ka mbaruar dot në fund të korrikut.

Zonja tha këtu se donte kohën e duhur. Çfarë kohe? 6 muaj për të bërë negociim për të firmosur? Këtë vërejtje kam unë, që këto negociime të bëhen më efektive, më të shpejta, brenda një muaji. Mundësisht të vinte këtu në parlament, të zinte radhën përpara 30 korrikut që mbaronte marrëveshja. Mund të ishte parlamenti pastaj që do ta diskutonte marrëveshjen në fund të tetorit apo nëntorit sipas radhës, sipas programit dhe kalendarit, që e thatë edhe ju në fillim. Është çështje kalendari, por jo vendimi të dalë më 22 shkurt, para 10 ditëve dhe më 1 mars, sot ta votojmë.

Ajo që tha zonja Hysi është e vërtetë, do të kalojë të martën apo të mërkurën kur do të jetë parlamenti, do 15 ditë të botohet në Fletoren Zyrtare, do të marrë *Ok*-in nga Presidenti dhe i bie që 31 marsi mund të “digjet”, në sensin që t'i e ke kaluar në parlament, por nuk është bërë.

Zoti Bushati, efektiviteti i punës së marrëveshjes që mund të bëjnë përfaqësuesit e qeverisë me donatorë të huaj duhet të jetë më i shpejtë dhe nuk mund të vazhdojë 6 muaj. Mësohuni pak me ritmin e punës së parlamentit!

Mimi Kodheli – Të gjithë e kuptojmë se ky është një miratim *post-factum* apo jo?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, zoti Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke mos i hequr asnjë presje fjalëve të zotit Fino, që i shprehu edhe dje në Komisionin e Ligjeve, lidhur me vonesat, duke kërkuar nga qeveria dhe nga organizmat në varësi moszvarritjen e këtyre marrëveshjeve.

Kërkoj që të shprehim të njëjtin qëndrim sikurse edhe dje në Komisionin e Ligjeve, pra ta miratojmë njëzëri këtë marrëveshje. Pastaj në relacionin përkatës të shprehen edhe gjetjet e zotit Fino.

Mimi Kodheli - Faleminderit!

Me shpresën se informacioni që iu është kërkuar në Komisionin e Ligjeve dhe në Komisionin për Veprimtaritë Prodhuese, i cili është komisioni përgjegjës, të mund të na vijë

edhe ne sa më shpejt të jetë e mundur, pasi kalon për miratim në seancën plenare të datës 5 mars, ora nuk dihet.

Kërkoj vëmendjen tuaj për ta kaluar për miratim. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Ju lutem, kur vjen informacioni? Sot! Dakord

Faleminderit!

Punë të mbarë!

Meqenëse e miratuam në parim. Kalojmë nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kush është dakord në tërësi? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Politikën e Jashtme

PROCESVERBAL

Tiranë, më datë 01.03.2019, ora 09:00

Drejton mbledhjen:

Mimi Kodheli – kryetare e Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektligjit “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve, dhe marrëveshjes së saj zbatuese”

Marrin pjesë:

Mimi Kodheli, Adnor Shameti, Ervin Bushati, Elona Hoxha, Vasilika Hysi, Eglantina Gjermani, Andrea Marto, Ditmir Bushati, Bashkim Fino dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Nard Ndoka, Rudina Hajdari, Evis Kushi, Alket Hyseni dhe Reme Lala.

Të ftuar:

Besfort Lamallari – Zëvendësministër i Brendshëm

Dalimir Kurti – Specialist në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive në Ministrinë e Brendshme

Thimio Plaku – Drejtor i Përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Ela Dobi – Specialiste në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Nikolin Bërzhiku – Specialist në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë

Mimi Kodheli - Kalojmë te projektligji “Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”.

Të pranishëm kemi Besfort Lamallari, zëvendësministër i Brendshëm.

Mirë se vini!

Kemi këtu zotin Kurti, specialist në Drejtorinë e Politikave dhe Strategjive.

Kemi zotin Plaku, drejtor i përgjithshëm në Ministrinë e Infrastrukturës. Faleminderit!

Kemi zotin Berxhiku, specialist.

Zoti zëvendësministër, ju lutem dy fjalë shkurt për projekt marrëveshjen.

Besfort Lamallari – Faleminderit, zonja kryetare!

Të nderuar deputetë,

Duke kursyer edhe kohën tuaj shumë të çmuar do të thosha shkurtimisht se kjo marrëveshje përmban rregullat për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së daktiloskopike dhe të dhënat e regjistrimit të automjeteve.

Kjo marrëveshje është nënshkruar nga qeveria shqiptare me 13 shtator 2018 në Vjenë. Janë gjithsej 11 vende të Konventës së Bashkëpunimit Policor në Europën Juglindore, nga të cilat 5 të BE-së dhe 6 të Ballkanit Perëndimor, të cilat kanë negociuar këtë marrëveshje, përveç Sllovenisë, e cila për shkak të ndryshimeve në qeveri nuk pati mundësi të merrte fuqinë për nënshkrimin e saj dhe Bosnjës, e cila nuk ka një databazë unike. Të gjitha vendet e tjera përmes nënshkrimit dhe zbatimit të kësaj marrëveshjeje do të kenë mundësitë reale për shkëmbimin e automatizuar online të të dhënave, profileve të ADN-së, gjurmëve të gishtave dhe të automjeteve që do të thotë se Shqipëria do të ketë akses të drejtpërdrejt në databazat e 10 vendeve të tjera, 5 nga të cilat janë vende të BE-së.

Ajo çka bën efektivisht të mundur kjo marrëveshje është se ndihmon ndjeshëm luftën ndaj krimit të organizuar dhe hetimet penale pasi mund të identifikohen jo vetëm ata persona të shtetit shqiptar të cilët kanë kryer vepra penale në Shqipëri dhe jashtë vendit, por edhe shtetas të huaj, të cilët mund të kenë kryer vepra penale në Shqipëri, pavarësisht faktit se ata mund të ndryshojnë identitetin e tyre, pasi në fund të fundit të dhënat biometrike nuk mund të ndryshohen. Ky është thelbi i marrëveshjes, që përmes Komisionit European dhe kanalit të komunikimit Testa, që është një kanal i enkriptuar, të mundësohet zbatimi në praktikë i marrëveshjes për të gjitha vendet. Për fatin e mirë, Austria ka marrë përsipër rolin e mentorit për Shqipërinë, si në aspektin politik, edhe në aspektin financiar ku po llobohet me vende të ndryshme për të siguruar fonde për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

A ka pyetje? Diskutime?

Urdhëroni, zonja Gjebrea!

Elona Gjebrea – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Sigurisht që është një marrëveshje e rëndësishme dhe aq më tepër forcon bashkëpunim policor ndërkufitar në luftën kundër terrorizmit, krimit ndërkufitar, emigracionit të paligjshëm e kështu me radhë.

Unë kam vetëm një pyetje. Brenda këtyre vendeve, të cilat janë pjesë e bashkëpunimit policor me Europën Juglindore, sa nga këto vende e kanë nënshkruar një marrëveshje të tillë dhe ku qëndron Shqipëria në lidhje me këtë?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Meqë kemi zëvendësministrin e linjës, unë doja të pyesja për protestat. Opozita në definicion është kundër dhe patjetër ka të drejtën e protestës paqësore, kjo ndodh në të gjitha vendet e botës. A mund të na jepni një ekspozitë të shkurtër, se sa nga ata që kanë bërë dhunë kanë qenë elementë kriminalë? Si mund të procedohet në të ardhmen që të dekurajohet sa më shumë përdorimi i dhunës në protesta, nëse do të ketë?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zoti zëvendësministër, para se t'i përgjigjeni pyetjes unë mendoj që pyetja që ju bëtë zoti Bushati ka të bëjë me një çështje shumë rëndësishme. Kështu, nëse ne jemi të interesuar për të ditur nivelin e masave të marra, patjetër edhe të shkëmbimit të të gjitha të dhënave të personave që shkelin ligjin, keqbërës, trafikantë e kështu me radhë, mund të thërrasim në dëgjuesë në këtë komision përfaqësuesit e ministrisë. Sigurisht, ne kemi të drejtë ta përcaktojmë nivelin e konfidencialitetit të dëgjuesës, në mënyrë që të marrim një informacion më të detajuar lidhur me këtë çështje. Kështu, zoti zëvendësministër ju mund t'i përgjigjeni pyetjes së zonjës Gjebrea! Më pas zonja Hysi keni fjalën për pyetje.

Besfort Lamallari – Faleminderit, zonja deputete, për pyetjen!

Atëherë, të 11 vendet që e nënshkruan këtë marrëveshje janë pjesë e Konventës së Bashkëpunimit Policor. Më 13 shtator të vitit 2018, përveç Sllovenisë dhe Bosnjës, për arsye politike, teknike apo për mungesë të *database*-ve, të gjitha vendet e tjera e nënshkruan këtë marrëveshje dhe janë në procesin e ratifikimit, sigurimit të mjediseve dhe kushteve teknike për implementimin e saj.

Mimi Kodheli – Po, zonja Hysi.

Më pas fjalën e ka zonja Gjebrea.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti zëvendësministër, që jeni i pranishëm!

Unë kam një pyetje që nuk e bëra në komision tim, sepse e lidha pikërisht me Komisionin e Jashtëm. Sipas një raporti të përgatitur nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale jo të gjitha vendet kanë një shkallë të sigurisë në transmetimin e të dhënave. Unë dua të di nëse shtete të tilla si: Bosnjë Hercegovina dhe Republika e Moldavisë sa futen në kategorinë e shteteve që kanë siguri në transmetimin e të dhënave personale dhe në mbrojtjen e tyre? Të paktën kjo është një nga çështjet që vazhdimisht komisionari e ngre kur raporton për nevojën e bashkëpunimit dhe forcimit të sigurisë.

Së dyti, e lexova përsëri relacionin dhe këtu rezulton se do të transmetohen edhe të dhënat që kanë të bëjnë me ADN-në. Këtu thuhet se do të gjenden personat e humbur, personat që kanë vdekur apo mbetjet e eshtrave. Pse në marrëveshje është vënë aq shumë theksi pikërisht te këto dy kategori, pra, jo te personat që kërkohen, por te personat që mund të jenë gjallë, personat që kanë kryer aktivitete kriminale apo që mund të jenë larguar? Ky është fokusi kryesor, sepse në çdo paragraf të marrëveshjes është vënë shumë theksi te mbetjet, te personat e humbur, te personat e zhdukur dhe më krijon idenë se është një marrëveshje tjetër për gjetjen e personave të zhdukur në periudhën e regjimit komunist.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Zonja Gjebrea, a keni pyetje?

Elona Gjebrea – Po.

Në fakt, siç e tha zëvendësministri, ne do të kemi mentor dhe mbështetës Austrinë. A kemi ne ndonjë bashkëbisedim apo ndërmjetësim për një fond të caktuar buxhetor në lidhje me këtë, sepse besoj se e gjithë kjo kërkon edhe ngritje kapacitetesh, edhe nga Policia Shkencore, edhe trajnime e të tjerë? Si jemi ne në lidhje me këtë?

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Po, zoti zëvendësministër.

Besfort Lamallari – Atëherë, lidhur me pyetjen e bërë nga zonja Hysi, do të thosha që pjesën e parë duhet ta shikojmë në dy këndvështrime: garancia ligjore dhe garancia teknike për ruajtjen e konfidencialitetit. Për pjesën e garancisë ligjore mjafton të themi se kjo marrëveshje është një replikim i Traktatit të Prum-it, i cili është zbatuar me sukses në nivel evropian për shkëmbimin automatik të të dhënave, që përfshin edhe kjo marrëveshje. Në këtë aspekt për të

gjitha vendet e tjera nënshkruese, të cilat aspirojnë të integrohen në BE, ky është një standard minimal, që zbatohet dhe është në rregull në këtë drejtim.

Në aspektin teknik marrëveshja ka trajtuar me shumë kujdes të gjitha elementet, që garantojnë ruajtjen e konfidencialitetit, duke filluar nga pikat e kontaktit që do të jenë në çdo institucion.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale merr një rol të veçantë në mbikëqyrjen e transmetimit të këtyre të dhënave, por edhe vetë kanali i komunikimit, që është sistemi TESTA, i cili është ofruar nga Komisioni European. Ky sistem është i kriptuar dhe funksionon vetëm mbi baza fundore, që do të thotë vihen në dijeni vetëm palët që shkëmbejnë informacion dhe asnjë tjetër.

Për sa i përket mbulimit financiar, është e vërtetë që do të ketë kosto, por, përtej kësaj marrëveshjeje zbatimi dhe implementimi i sistemit TESTA sjell përfitime më të mëdha sesa vetë marrëveshja, pasi përmes këtij kanali komunikimi shkëmbejnë të dhëna shumë agjenci të tjera, si Europol, dogana dhe tatime. Por në këtë fazë përmes AKSHI-t ne jemi munduar të identifikojmë të gjitha agjencitë e tjera, përfshirë edhe shërbimet inteligjente, që janë të interesuara për të shkëmbyer të dhënat përmes këtij kanali komunikimi.

Në momentin e nënshkrimit të marrëveshjes një zhvillim pozitiv ishte edhe nënshkrimi i një memorandumit mes të gjithë ministrave nënshkrues, që ishte një thirrje e hapur për të gjitha organizatat dhe donatorët e mundshëm në nivel europian, për ta mbështetur financiarisht këtë marrëveshje.

Lidhur me fokusin e kësaj marrëveshjeje, sigurisht që është lufta kundër krimit të organizuar dhe atij ndërkuftar. Pra shkëmbehen të dhëna dhe profile ADN-je, gjurmë gishtash e të tjera për personat që kryejnë vepra penale, gjithashtu, kjo lehtëson dhe mundëson gjetjen e personave të humbur, e personave të zhdukur nga lufta e të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ne njëkohësisht po ecim në dy drejtime, së pari, me gjetjen e donatorëve, pra Sekretariati i Përgjithshëm i Konventës së Bashkëpunimit Policor po mundohet të identifikojë donatorë të ndryshëm, të cilët duhet të ndihmojnë vendet anëtare.

Përmenda edhe faktin që Austria ka marrë përsipër, me kërkesë të Ministrisë së Brendshme, të jetë mentor i Shqipërisë. Vullneti i tyre ishte pozitiv, pasi sollën ekspertët e tyre për të vlerësuar gjendjen e *database*-ve në Shqipëri. Nga takimi që pata me përfaqësuesit e tyre, më informuan që ishin të kënaqur me nivelin e *database*-ve që përdoren në Shqipëri, por sigurisht që ka vend për përmirësime. Pra ne jemi jo vetëm për përmbushjen e marrëveshjes, por edhe për sigurimin e kanalit të komunikimit TESTA, pra përveç Ministrisë së Brendshme

duam që të përfshihen të gjithë ata agjencitë, të cilat përfitojnë nga ky kanal komunikimi, pra të ketë gjithëpërfshirje.

Ky proces shkon përtej marrëveshjes dhe kërkon një vëmendje të veçantë edhe në buxhetin e shtetit, ku të gjitha agjencitë duhet të shpërndajnë kostot.

Mimi Kodheli – Përpara se zonja Gjebrea të bëjë pyetjen e radhës, unë dua të di nëse në buxhetin e ardhshëm do të vini me një planifikim tuajin, përtej çfarë agjencitë ndërkombëtare bëjnë për ta suportuar këtë proces dhe kjo duhet rakorduar me agjencitë e tjera?

Këtu prezent është drejtori që mbulon sektorin e targave dhe jam në të drejtën time të vë në pikëpyetje sistemin që përdorim, pra sa i sigurt është *database* i targave të makinave, sepse duhet të ketë një unitet të dedikuar dhe duhet të rritet niveli i sigurisë së sistemit, në mënyrë që të mund të bëhet pjesë e atij sistemi qendror që ju po flisni. Mbase nuk e kam këtë informacion, por unë dyshoj që këto të dhëna ruhen në mënyrën e duhur, nëse përdoret sistemi i duhur IT dhe nëse ka njerëz të dedikuar, prandaj besoj se duhet krijuar si unitet dhe për këtë drejtori mund të thotë diçka më tepër.

E dyta, dua të di cili është roli i AKSHI-t si truri qendror i ruajtjes dhe përpunimit të disa të dhënave dhe i këtij sistemi? Sa është AKSHI protagonist në këtë gjë? A do të ketë nevojë, edhe për AKSHI-n, për fonde shtesë dhe persona të tjerë të dedikuar, meqenëse flasim për një proces, i cili kërkon besim dhe pastaj përgatitje të trupës në Ohajo, përditësimi me programet e tyre, ruajtjen e të dhënave të individit, sepse hyjnë në lojë të drejtat e njeriut, pavarësisht se bëhet fjalë për ADN-në e personave, jo qytetarë të rregullt.

Së treti, ku është Kosova në gjithë këtë proces?

Elona Gjebrea- Me aq sa unë kam informacion shumë shtete kanë kërkuar shkëmbim informacioni për këtë qëllim që sigurisht është forcimi i sigurisë publike ndërmjet shteteve. Në këtë mënyrë ndoshta duhet edhe një strategji si do të operohet me vendet e tjera që pas kësaj marrëveshjeje do të kërkojnë shkëmbim informacioni, për shembull, Mbretëria e Bashkuar do të kërkojë marrëveshje dypalëshe dhe këtu mbase duhet të keni një strategji si do të jetë më tej kjo gjë. Përveç forcimit të sigurisë, duhet pasur kujdes edhe mbrojtja e të dhënave personale të personit.

Ditmir Bushati – Zonja kryetare, ju me të drejtë pyetët ku është Kosova në këtë proces. Duke pasur parasysh ambicien e shprehur nga qeveria shqiptare për heqjen e çdo lloj kontrolli kufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës, por edhe detyrimet që ka Shqipëria, sepse neve na takon për të folur për Shqipërinë, Kosova nuk është pjesë e kësaj marrëveshjeje, kuptohet që arsyet janë politike. Sa e pengon kjo marrëveshje ose përkatësia jonë në këtë marrëveshje? Ju folët, gjithashtu, për INTERPOL-in EUROPOL-in, që janë çështje shtesë të handikapëve që ka

procesi i heqjes së çdo lloj kontrolli kufitar, po sa kjo marrëveshje e vë në pikëpyetje procesin e nisur me Kosovën?

Në relacion i referoheni kuadrit të PRUM-it me të drejtë, në fakt, fillesat janë që në vitin 1999, me TEMPER-ën, këshillin e saj dhe me komplet paketën për drejtësinë dhe punët e brendshme që fillojnë dhe që më pas u inkorporua në detyrimet që kanë vendet që synojnë anëtarësimin në BE.

Gjëja që është e vështirë dhe mendoj që ia vlen të kemi një diskutim të madh në të gjitha nivelet është fatura financiare e zbatimit të kësaj marrëveshjeje dhe sistemi i ndërveprimit të institucioneve shqiptare, sepse Ministria e Brendshme është porta hyrëse ose pika e kontaktit për zbatimin e kësaj marrëveshjeje.

Unë do t'ju them nga eksperiencia personale që një institucion shtetëror i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Transportit Rrugor. Po ju jap një rast konkret, Drejtoria e Përgjithshme e Transportit Rrugor, kishte sjellë një shkresë për një makinë të regjistruar në emrin e iks personi, më pas personi i interesuar shikon se nuk është bërë ky regjistrim dhe kërkesa nuk kthehet mbi bazën e numrit të IT-së, që është individualizuar për çdo shtetas shqiptar, por thjesht emër mbiemër, por me emër mbiemër të njëjtë mund të jenë edhe 700 shqiptarë. Më pas, personi i interesuar, duke qenë se kishte referencë personale interesohet dhe merr të njëjtën shkresë, por me përgjigje mohuese, duke i thënë që nuk ka një makinë në emër të këtij personi. Kjo provon një reaksion zinxhir dhe vështirësi të panumërta për punën e Policisë së Shtetit për të mos shkuar më pas tek të dhënat personale, përfshirja e komisionerit, Avokatit të Popullit, për pjesën që mbulon në raport me administratën, të cilësia e ndërveprueshmërisë së institucioneve tona ligjzbatuese të vendeve që janë pjesë e kësaj marrëveshjeje, pra i gjithë kuadri fillon dhe vihet në pikëpyetje dhe gjithë diskutimi ynë, i karakterit përgjithësisht teorik dhe institucional, mund të ketë pasoja të pariparueshme në praktikë.

Pra, nuk besoj se ka njeri nacional që të ketë pikëpyetje për leverdinë dhe domosdoshmërinë e qenies së Shqipërisë pjesë në këtë marrëveshje. Shqetësimi që kam edhe në kuadrin e kapitujve 23 dhe 24, ende nuk kemi një ndërgjegje të plotë për gamën e detyrave dhe investimeve që duhet të bëjmë në këtë proces *screening* me Komisionin European.

Shqetësimi është: a do të fillojmë të kemi një hartë rruge në 2, 4, 5 vjet? Kur lexova relacionin, pashë parashikimet që ka Ministria e Brendshme me programet e Bashkimit European dhe mund t'ju them që nuk është i reflektuar si prioritet. Pra, kur flasim për parashikimet buxhetore, nuk është aspak i reflektuar si pjesë e asistencës qoftë *soft* apo *hard*. Kur nuk e kemi parashikuar të buxheti i shtetit objektin e asaj që konsiderohet *public*

scrutinin, duhet ta kemi diku tjetër të monitorueshme, pra në qoftë se ne nuk kemi *public scrutiny* për këto lloj procesesh, nesër a pasnesër mund të jemi në rrezik, sepse vende shumë më të zhvilluara se ne kanë kaluar në këto peripeci, e jo më ne.

Faleminderit!

Besfort Lamallari – Faleminderit!

I vlerësoj të gjitha pyetjet, të cilat janë vërtet teknike. Ne jemi duke i trajtuar realisht këto pyetje si me AKSHI-n, si me Komisionin European.

Për sa i përket AKSHI-t, zonja kryetare, gjatë kohës që po negocionim marrëveshjen, u futëm në diskutim edhe me AKSHI-n dhe impulsi i parë ishte që Ministria e Brendshme të merrte rolin drejtues, ose të ishte porta hyrëse, siç e përmendi edhe zoti Bushati. Në fakt, kuptuam që kjo ofronte më tepër mundësi se sa ishte vet fokusi i kësaj marrëveshjeje, prandaj e stopuam në një farë mënyre dhe donim që të përfshiheshin sa më shumë agjenci, kryesisht thirrje nën drejtimin e AKSHI-t për vet rolin që ka, që do të thotë që edhe kostot pastaj planizohen mbi bazën e përfshirjes së agjencive dhe ndarjes në buxhete përkatëse, krahas garës që po bëhet me sigurimin e donatorëve të jashtëm.

Ka edhe një program tjetër, IZA2 Program, i cili është shfrytëzuar nga disa vende të Ballkanit Perëndimor, por ka procedurat dhe kohëzgjatjen e vet, që ofron financim pikërisht për këtë program. Ne vendosëm në mënyrë arbitrare që do të jemi pika fokale duke qenë se ne nuk parashikuam të ishte Ministria e Brendshme, por kjo duhet të dakordësohej nga të gjitha institucionet përkatëse. Kjo është edhe arsyeja pse nuk e parashikuam në buxhet si zë më vete.

Për pjesën e Kosovës, është e drejtë, është një shqetësim që ne e kemi pasur vazhdimisht. Me të drejtë u citua edhe konventa, e cila nuk ka si vend anëtar Kosovën dhe kjo është për arsye se si është përjashtuar që në fillimet e nënshkrimit të konventës, megjithatë ajo çfarë kemi bërë për të krijuar mundësinë praktike për afrimin e Kosovës drejtë këtij mekanizmi, Konventës së Bashkëpunimit Policor, gjatë kryesimit të fundit 6-mujor, pra deri në dhjetor Shqipëria e ftoi Kosovën në disa evente në rolin e të ftuarit, dhe këtë e lejon konventa, u organizuan 3 evente kryesore nga të cilat njëra ishte takimi i përgjithshëm i drejtorëve të Policisë Kriminale dhe kishte përfaqësues edhe nga Kosova.

Një element tjetër që kemi bërë në këtë drejtim është edhe inicimi i procesit për nënshkrimin e Konventës së Bashkëpunimit Policor me Kroacinë për t'u bërë pjesë që të kthehet në anëtare dhe nënshkruese të kësaj marrëveshjeje, që do të thotë një gamë më e gjerë vendesh dhe *database*-sh.

Para dy ditësh mora lajmin pozitiv nga ambasadorja kroate, e cila na njoftoi se parlamenti kroat e ka ratifikuar këtë marrëveshje dhe ne si vend depozitues, u njoftuam edhe

zyrtarisht përmes Ministrisë së Jashtme edhe të gjitha vendet e tjera. Me hyrjen e Kroacisë, sigurisht, shtohen edhe mundësitë reale për diskutimin për Kosovën.

Kjo ishte arsyeja që ne synuam fort dhe e mbështetëm aplikimin e Kroacisë në këtë proces.

Sa i takon sistemit të targave shqetësimi që ngrihet është i drejtë, por edhe këtu ka një *database* të veçantë, që përdoret në nivel evropian, EUCARIS Shqipëria e ka ratifikuar këtë marrëveshje më parë dhe mbetet vetëm zbatimi i saj. Pra, kjo do të thotë që ka një fond të caktuar, ku ne së bashku me TESA-n dhe sistemin EUCARIS kemi negociuar me komisionin për të na dhënë disa shifra të përafërta se cilat mund të jenë *fee*-të, tarifatat, që duhet të paguaj një vend anëtar për shfrytëzimin e tyre.

Sistemi, sigurisht që është absolutisht i sigurt. Pse është i sigurt? Është i sigurt, sepse, së pari, ndërtimi dhe funksionimi i tij bazohet mbi një sistem *Hide No Hide Bases*, e cila do të thotë që nga e gjithë *database* e gjurmëve të gishtave apo profileve të ADN-së që mund të ekzistojnë të ruajtura në një shtet anëtar të bëhet një kontroll automatik dhe vetëm aty ku gjendet një gjurmë, për shembull, një gjurmë që është kërkuar nga vendi i krimit, vetëm atëherë identifikohet kjo gjurmë dhe i thuhet organit të procedimit penal që kjo gjurmë ka ngjashmëri më të madhe, atëherë Prokuroria, sipas Kodit të Procedurës Penale kërkon verifikimin e kësaj gjurme, duke u bërë edhe identifikimi i personit.

Gjithsesi, marrëveshja parashikon edhe garanci të tjera, siç janë: pikat e kontaktit, Komisioneri i Mbrojtjes së të Dhënave Personale apo edhe të drejtat që kanë qytetarët për të kërkuar informacion lidhur me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, pra nëse ato kanë qenë subjekt i verifikimeve të ndryshme.

Sa i takon pyetjes sa e vë në pikëpyetje procesin me Kosovën, unë mendoj se nuk ka ndonjë konflikt në këtë aspekt, pasi, siç jua thashë, Kosova nuk është pjesë e marrëveshjes së Konventës për Bashkëpunimin Policor, megjithatë Shqipëria i ka bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të shfrytëzuar mekanizmat që lejon konventa për ta ftuar Kosovën në takime të ndryshme të nivelit teknik, të cilat janë shumë të dobishme.

Me hyrjen e Kroacisë, sigurisht që do të kemi më shumë vota pro në momentin kur të vijë rasti të diskutohet për Kosovën. Absolutisht ky është prioritet yni kombëtar, por edhe i Ministrisë së Brendshme për të bërë të mundur zgjerimin dhe hyrjen e Kosovës në çdo marrëveshje të ngjashme.

Faleminderit!

Mimi Kodheli – Faleminderit!

Në fakt, me të drejtë zoti Bushati foli për një strukturë siç është Drejtoria e Përgjithshme e Patentave, e cila në gjykimin tim, për shkak edhe të eksperiencave personale apo edhe në këtë pozicion, është një strukturë, gjithmonë kur flasim për çështjet e sigurisë, sepse më pas kush bën çfarë për arsye teknike, ky është një diskutim tjetër. Unë mendoj se duhet të rishihet dhe të ndryshohet në mënyrë radikale mënyra, qëndrimi ndaj shkëmbimit të të dhënave, apo të dhënave të *database*-t që kjo drejtori mban. Pse e them këtë? E them këtë për një arsye madhore, siç është ajo që përmendi zoti Bushati, ku disponuesit e një mjeti apo të një licence për dhënie makine ekzistojnë me emër, mbiemër, ndërkohë që në Shqipëri ka me qindra njerëz që kanë të njëjtin emër dhe mbiemër.

Ndërkohë, zoti Bushati ishte duke folur për një detaj në dukje banal, por në gjykimin tim të rëndësishëm. Dikur personalisht disponoja një patentë që nga viti 1993, e cila kishte në të dhënat, qoftë edhe në kartonin, jo atë të vjetrin, grupin e gjakut, ndërsa sot e keni hequr. Pra, ne jemi duke folur për të dhëna ADN-je, kurse ju keni hequr grupin e gjakut nga licenca e dhënies së makinës.

(Diskutime pa mikrofon)

Unë mendoj që në disa drejtime kemi bërë hapa mbrapa, ndërkohë që duhet të bënim hapa përpara. Në botë ka vende që në patentë kanë të regjistruar çdo gjë, sepse me patentë udhëtohet dhe dilet jashtë kufijve të vendit. Pra, sa më shumë ne përqendrojmë të dhënat e një qytetari në një dokument, në një mjet, ju mund t'ia vini emrin si të doni, për institucionet ligjzbatuese kjo është më e thjeshtë për ta identifikuar personin, aq më e thjeshtë është që të gjitha këto procese dhe projekte në të cilat Shqipëria aderon të mund të menaxhohen, se më krijohet ideja sikur ka shumë projekte të BE-së, të Interpol-it dhe të strukturave të tjera bilaterale, të cilat, në fund të ditës, më shumë se sa e thjeshtojnë problemin, e komplikojnë atë. Prandaj mendoj se duhet të ketë më shumë struktura, më shumë kosto dhe më shumë individë që duhet të merren me këto projekte. Vendet e mëdha e kanë këtë mundësi, por mendoj se edhe Shqipëria, që është një vend i vogël, duhet të jetë më racionale në këtë drejtim.

Së fundi, ne e dimë që ka komisionerë të të drejtave të njeriut, ka transparencë dhe jam shumë dakord për respektimin e të gjitha institucioneve të krijuara nga shteti shqiptar lidhur me këtë që po themi, por nuk e di se sa gjurmë lë ndërhyrja në këto sisteme, bazuar edhe në softet që përmendi Ditmiri, që dikush, i cili e supervizon këtë sistem, të mund të kuptojë. Cila është garancia që më jepni ju, që nuk ka manipulim të të dhënave të *database*-it? Domethënë, unë besoj, ndoshta edhe për shkak të detyrave që kam pasur më përpara, se ka sisteme që, nëse ndërhyr me kodin tënd personal, kuptohet se kush ka ndërhyrë në sistem, kush ka manipuluar,

manipulim quhet edhe kur fut një *database* të saktë të të dhënave, dhe kush e ka këtë të drejtë. Sigurisht, duke u bazuar në Kushtetutë, a e ka këtë siguri kjo marrëveshje?

Besfort Lamallari - Atëherë, për sa u përket targave të automjeteve, pra të dhënave të automjeteve, sigurisht sistemi EUCARIS, që unë përmenda, lejon kalimin dhe transmetimin në mënyrë të sigurt të të dhënave, i cili shoqërohet edhe me një soft, që ka një *template* të caktuar në nivel europian dhe që do të aplikohet një replikim i dytë për vendet e konventës, që është kërkuar edhe nga instancat e Komisionit Europian, që do të thotë se të dhënat do të futen në këtë soft.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në momentin që bëhet e zbatueshme, instalohet softi dhe kalimi i të dhënave është i sigurt. Softi është standard dhe do të jetë standard për të gjitha vendet nënshkruese të marrëveshjes.

Për sa i përket shqetësimit që ngritët ju, zonja kryetare, sigurisht që është serioz. Komisioni ka garantuar që aksesimi dhe transmetimi i të dhënave përmes kanalit TESA është i enkriptuar, është i sigurt dhe ka të njëjtin parim midis pikave. Pra, shkëmbimi i informacionit është i sigurt midis pikave fundore, midis transmetuesit dhe marrësit. Shqetësim mund të ishte vetëm nëse transmetuesi fut të dhëna të gabuara, që do të thotë...

Mimi Kodheli - Unë kam problem manipulimin e të dhënave, domethënë shenjat e mia të gishtave i kalojnë shenjave të gishtave të dikujt tjetër dhe në vend që të dalë ai tjetri kriminel, ne jemi duke bërë mbledhje këtu me ty, del që jam duke kryer një krim. Më falni, sepse po e banalizoj.

Besfort Lamallari- Pikërisht për këtë arsye,....

Mimi Kodheli - Sa siguri ka sistemi në këtë gjë?

Besfort Lamallari - Pikërisht për këtë arsye... Pra, nëse unë përmend atë të targave, që thotë të instalohet një soft i posaçëm. Për pjesën e ADN-së dhe pjesën e të dhënave daktiloskopike ka dy softe të ndryshme që janë ofruar dhe mbikëqyren nga donatorë, nga ICITAP-i për pjesën e ADN-së, dhe nga AFISI, që është një eksperiencë shumëvjeçare, që funksionon dhe është azhurnuar, megjithatë, për të krijuar këtë garanci ne u kërkuam austriakëve që të sjellin ekspertët e tyre nga Ministria e Brendshme austriake për t'i verifikuar në terren. Para disa kohësh kishim një vizitë inspektuese nga ata, të cilët i panë sistemet dhe thanë që funksionojnë shumë mirë dhe janë në standardet që mund të garantojnë.

Fjalën e ka zoti Shameti për procedurë.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Duke shprehur mbështetjen për të gjitha gjetjet tuaja, si nga ju, si nga anëtarët e tjerë të komisionit, dua t'ju siguroj që në Komisionin e Sigurisë, si komision përgjegjës, ne do t'i marrim me vetë këto, do t'i përmbledhim të gjitha dhe do ta bëjmë ashtu siç duhet. Në këto kushte, nuk mbetet gjë tjetër veç ta miratojmë njëzëri.

Mimi Kodheli – Zoti Bushati.

Ditmir Bushati – Duke rënë 100% dakord me zotin Shameti për ndarjen e punës midis komisioneve, unë kthehem edhe një herë te pyetja që ju bëra. Nuk e vë në dyshim që çdo institucion i shtetit shqiptar bën maksimumin për ta përfshirë Kosovën në të gjitha këto nisma, se është prioritet. Unë bëra një pyetje. Ne marrim disa angazhime këtu. Një pjesë të tyre, në kuptimin praktik të fjalës, u përpoqëm t'i shpjegonim. Kemi disa angazhime në procesin e liberalizimit të vizave, pra kemi një kontratë me BE-në në këtë drejtim. Nga ana tjetër, kemi marrë angazhimin që të heqim çdo kontrolli kufitar me Kosovën, që është angazhimi ynë i brendshëm, buron nga nevoja jonë e brendshme, pra nuk është një angazhim ndërkombëtar. Të gjitha këto angazhime ndërkombëtare krijojnë një sistem ndërveprimi, pra në të gjitha këto vendet ku jemi rreshtuar, pa Kroacinë, që ju thoni se tani po përfshihet në këtë proces, e kemi këtë lloj shkëmbimi të të dhënave. Në procesin e liberalizimit të vizave, kur u futën të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, pa Kosovën, të gjitha institucionet ligjzbatuese kishin disa angazhime të përbashkëta. Ju shtuat me shumë të drejtë edhe Interpolin, ku ne jemi, ata nuk janë, Europolin, Fronteksin, që të gjitha, në një mënyrë apo në tjetër, kanë lidhje me këto proces. Ky është një lloj angazhimi që ne marrim. Edhe kur flasim për Shengenin, ajo që shohim ne është mungesa e kontrollit, por pas Shengenit është databaza për pasuritë e sekuestruara nga aktivitete kriminale, të dhënat personale, makinat. Ky lloj minikuadri, që ne krijojmë këtu me shumë të drejtë, që do të kërkojë kohë për t'u implementuar, për t'u përsosur etj., a e vë disi në pikëpyetje këtë procesin tjetër, apo janë çështje komplementare dhe ne po marrim masa për t'i parë si të tilla? Kjo ishte pyetja.

Mimi Kodheli – Urdhëroni, zoti Llamari!

Besfort Lamallari – Në lidhje me shqetësimin që thashë, është ekzistues dhe duhet marrë në konsideratë garantimin e targave, për të shmangur çdo abuzim të mundshëm, ka dy subjekte: njëri ka të bëjë me tabletat që u futën në qarkullim, domethënë verifikimi *online* nga oficeri i policisë rrugore i automjeteve. Kjo do të thotë se aty ka hapësirë për të verifikuar nëse mjeti është i vjedhur, nëse është në *red notice*. Identifikohet me targën, me numrin e shasisë, pra aty është i gjithë informacioni që lidhet *online* me sallën. Kjo është një përpjekje shumë e mirë, por Ministria e Brendshme ka identifikuar edhe nevojën e modernizimit të sistemit të kontrollit të targave. Domethënë, ashtu siç aplikohet në Europën Perëndimore me stikat që

regjistronen aty dhe janë kompanitë e siguracionit që ofrojnë këto stika dhe aty skanohen të gjitha të dhënat përmes aparaturave të veçanta në rrugë që shikon mjetet ose targave elektronike. Pra, duke e marrë në konsideratë këtë shqetësim, Ministria e Brendshme ka lëvizur në këto dy drejtime. Furnizimi me tableta u realizua, shumica janë shpërndarë në Tiranë, por edhe në çdo qark të vendit.

Për sa i përket pyetjes së zotit Bushati, sigurisht, kjo është një pyetje shumë më e madhe se sa vetë fokusi i kësaj marrëveshjeje, por qëndron bashkë me çdo marrëveshje të ngjashme, ku bëhet fjalë në kuadër të kësaj nisme të bashkimit të databazeve dhe kufijve me Kosovën. Deri më sot nuk ka pasur një shqetësim nga vendet anëtarë të Konventës së Bashkëpunimit Policor lidhur me këtë çështjeje. Sigurisht, në aspektin politik do të njihet vetëm Shqipëria si vend palë, por nuk shikoj ndonjë kufizim në aspektin e zgjerimit të databazeve. Madje në evente të ndryshme e kemi theksuar, dhe nuk ka pasur kundërshtime, që nuk mund të ketë bashkëpunim rajonal, ku ka ... Domethënë, kjo është arsyeja që ne këmbëngulëm dhe lobuam që Kroacia të ishte pjesë dhe kjo është arsyeja pse duhet të jetë edhe Kosova. Domethënë, sa më shumë databaze, sa më shumë shkëmbime informacioni në rajon, është në interes e të gjithë palëve, pa asnjë kundërshtim. Kurse në aspektin politik ka tjetër diferencë.

Mimi Kodheli – Faleminderit, zoti zëvendësministër!

Mendoj se konsuamua disa nga shqetësimet, por morëm edhe disa nga përgjigjet. Kështu që, mendoj se edhe në zbatim të porosisë që dha deputeti Shameti lidhur me shqetësimet e tjera, që mund të kemi si komision, pra t'ia transmetojmë komisionit përgjegjës.

(Diskutime pa mikrofon)

Kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Kush është dakord në parim me projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet palëve të Konventës së Bashkëpunimit Policor për Europën Juglindore, për shkëmbimin e automatizuar të të dhënave të ADN-së, daktiloskopike dhe të të dhënave të regjistrimit të automjeteve dhe marrëveshjes së saj zbatuese”. Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi të projektligjit.

Kush është dakord? Kundër? Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Faleminderit, zotit zëvendësministër!
Kolegë, faleminderit dhe punë të mbarë!
Mbledhjen e deklaroj të mbyllur.

MBYLLET MBLEDHJA